



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.507/15 prot

Datë 08.05.2024

V E N D I M

Nr. 469/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 08.05.2024 me

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga BOE “Biba-X” SHPK & “Bimak” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr.REF-94268-01-31-2024, me objekt: “*Blerje Asfalti*” me fond limit 37.500.000 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 19.02.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kavajë.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “A.L Asfalt” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Rruga Ura Asfaltim Nr.2 Elbasan” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr.REF-94268-01-31-2024, me objekt: “*Blerje Asfalti*” me fond limit 37.500.000 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 19.02.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kavajë.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Kavajë me adresë: Bulevardi “Josif Budo”, Kavajë

Ankimues: BOE “Biba-X” SHPK & “Bimak” SHPK me përfaqësues operatorin ekonomik “Biba-X” SHPK me NUIS K3261885N, me adresë: Kryeluzaj, Kavajë.

Operatori ekonomik “Rruga Ura Asfaltim Nr.2 Elbasan” SHPK me NUIS J62904264O, me adresë: Fshati Balez Poshte, zona kadastrale nr.1079, nr.pasurise 322/11, 1 km nga kryqezimi i fshatit Kusar, Elbasan

Subjekte të Interesuara: Operatori ekonomik “A.L-Asfalt” SHPK, me NUIS K81511508A dhe adresë: Durres Xhafzotaj SALLMONE Rruga Hoxheve, Zona kadastrale 3852, Nr pasurie 19/36.

Baza Ligjore: Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr.500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

1.3. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

1.4. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

1.5. Operatorët ekonomikë ankimues kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 02.02.2024, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr.REF-94268-01-31-2024, me objekt: “Blerje Asfalti” me fond limit 37.500.000 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 19.02.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kavajë.

II.2. Në datën 20.02.2024, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit përfundimtar të ofertave, përkatësisht:

1. “Biba-X” SHPK	24.437.260,00 lekë, skualifikuar
2. “Rruga Ura Asfaltim Nr.2 Elbasan” SHPK	24.658.770,00 lekë, skualifikuar
3. “Shkëlqimi 07” SHPK	27.260.029,00 lekë, skualifikuar
4. “A.L Asfalt” SHPK	37.001.301,00 lekë, kualifikuar

BOE “Biba-X” SHPK & “Bimak” SHPK, me përfaqësues operatorin ekonomik “Biba-X” SHPK, është njohur me arsyet e skualifikimit të ofertës së paraqitur prej tij, me argumentet si më poshtë vijon:

Oferta juaj per tenderin REF-94268-01-31-2024, me objekt Blerje asfalti eshte refuzuar:

1. *Nga verifikimi i kryer per dokumentat e tenderit te paraqitura ne SPE operatori ekonomik BIBA-X nuk ka paraqitur shtojces 8 (vetedeklarim).*

Dokumenti i ngarkuar nuk hapet eshte i demtuar. Eshte detyre dhe pergjegjesi e OE qe te ngarkoje dokumentat ne system ne menyren e duhur dhe te sigurohet qe cdo dokument i ngarkuar eshte i rregullt dhe hapet.

2. *Nga verifikimi i kryer per dokumentat e tenderit te paraqitura ne SPE pjesemarrresi ne BOE, operatori BIMAK nuk permbush piken 2.3.7 te DST nuk eshte i pajisur me certificate ISO 9001:2015 per mallrat objekt prokurimi. Ne fushat e aktivitetit per te cilat eshte certifikuar nuk perفشihen produktet bituminoze ose asfaltobetonet.*

3. *Nga verifikimi i kryer per dokumentat e tenderit te paraqitura ne SPE BOE nuk ka paraqitur shtojcen 2, sipas formatit te DST.*

4. *Nga verifikimi i kryer ne shtojces 8 (vetedeklarim) OE BIMAK nuk ka paraqitur asnje kamiona vetëshkarkues me 4 akse me kapacitet mbajtës minimumi 25 (njëzetepesë) ton*

ose kamiona vetëshkarkues me 4 akse me kapacitet mbajtës minimumi 18 (tetëmbëdhjetë) ton,, automjetet e paraqitura janë Koka terheqese + gjysmerimorkio qe nuk plotesojne kushtin kamiona me 4 akse. Si pasoje OE BIMAK nuk ka permbushur pjesen e tij ne pjesemarrjen ne BOE, pasi ka mare persiper te realizoje transport dhe nuk ka paraqitur asnje automjet transporti.”

Operatori ekonomik “Rruga Ura Asfaltim Nr.2 Elbasan” SHPK, është njohur me arsyet e skualifikimit të ofertës së paraqitur prej tij, me argumentet si më poshtë vijon:

Arsyet e skualifikimit:

“Oferta juaj per tenderin REF-94268-01-31-2024, me objekt Blerje asfalti eshte refuzuar:

1. Nga verifikimi i kryer per dokumentat e tenderit te paraqitura ne SPE dhe ne shtojces 8 (vetedeklarim) operatori ekonomik RRUGA URA ASFALTIM NR.2 ELBASAN ne Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit A: DEKLARATË Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës: Deklarata Përgjigje Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojmë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e mallrave dhe grafikun e lëvrimit të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor. Po [] Jo [X] Ne vetedeklarimin e operatori ekonomik RRUGA URA ASFALTIM NR.2 ELBASAN, shenja eshte vene te JO, duke vetedeklaruar se nuk i ploteson te gjitha specifikimet teknike sic udhëzohet ne dokumentat e tenderit dhe nuk marrin persiper te realizojne objektin ne perputhje me Listen e mallrave dhe grafikun e levrimit te percaktuar nga Autoriteti Kontraktor. Te gjendur perballe kesaj deklarate oferta juaj refuzohet.

2. Nga verifikimi i kryer ne shtojces 8 (vetedeklarim) RRUGA URA ASFALTIM NR.2 ELBASAN nuk ka paraqitur 2 kamiona vetëshkarkues me 4 akse me kapacitet mbajtës minimumi 25 (njëzetepesë) ton, 2 automjetet e paraqitura janë Koka terheqese + gjysmerimorkio qe nuk plotesojne kushtin kamiona me 4 akse. (Si pasoje OE SHKELQIMI 07 nuk ka permbushur piken 2.3.2 praragrafi 3, pasi ka paraqitur 1 nga 3 kamiona vetëshkarkues me 4 akse me kapacitet mbajtës minimumi 25 (njëzetepesë) ton).”

II.4. Në datën 28.02.2024, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE njoftimin e fituesit të procedurës së mësipërme të prokurimit. Ofertuesit ankimues janë njoftuar për arsyet e skualifikimit si vijon:

“1- BOE “BIBA-X & BIMAK”

Perkatesisht per arsyet e meposhtme:

1. Nga verifikimi i kryer per dokumentat e tenderit te paraqitura ne SPE operatori ekonomik BIBA-X nuk ka paraqitur shtojces 8 (vetedeklarim). Dokumenti I ngarkuar nuk hapet eshte I demtuar. Eshte detyre dhe pergjegjesi e OE qe te ngarkoje dokumentat ne system ne menyren e duhur dhe te sigurohet qe cdo document I ngarkuar eshte I rregullt dhe hapet.

2. Nga verifikimi I kryer per dokumentat e tenderit te paraqitura ne SPE pjesemarrresi ne BOE, operatori BIMAK nuk permbush piken 2.3.7 te DST nuk eshte I pajisur me certificate ISO

9001:2015 per mallrat objekt prokurimi. Ne fushat e aktivitetit per te cilat eshte certifikuar nuk perfshihen produktet bituminoze ose asfaltbetonet.

3. Nga verifikimi i kryer per dokumentat e tenderit te paraqitura ne SPE BOE nuk ka paraqitur shtojcen 2, sipas formatit te DST.

4. Nga verifikimi i kryer ne shtojces 8 (vetedeklarim) OE BIMAK nuk ka paraqitur asnje kamiona vetëshkarkues me 4 akse me kapacitet mbajtës minimumi 25 (njëzetepesë) ton ose kamiona vetëshkarkues me 4 akse me kapacitet mbajtës minimumi 18 (tetëmbëdhjetë) ton,, automjetet e paraqitura jane Koka terheqese + gjysmerimorkio qe nuk plotesojne kushtin kamiona me 4 akse. Si pasoje OE BIMAK nuk ka permbushur pjesen e tij ne pjesemarrjen ne BOE, pasi ka mare persiper te realizoje transport dhe nuk ka paraqitur asnje automjet transporti.”

3- RRUGA URA ASFALTIM NR.2 ELBASAN

Perkatesisht per arsyet e meposhtme:

1. Nga verifikimi I kryer per dokumentat e tenderit te paraqitura ne SPE dhe ne shtojces 8 (vetedeklarim) operatori ekonomik RRUGA URA ASFALTIM NR.2 ELBASAN ne Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË

Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës:

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e mallrave dhe grafikun e levrimit të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor.	Po [] Jo [X]

Ne vetedeklarimin e operatori ekonomik RRUGA URA ASFALTIM NR.2 ELBASAN , shenja eshte vene te JO, duke vetedeklaruar se nuk i ploteson te gjitha specifikimet teknike sic udhezohet ne dokumentat e tenderit dhe nuk marrin persiper te realizojne objektin ne perputhje me Listen e mallrave dhe grafikun e levrimit te percaktuar nga Autoriteti Kontraktor.

Te gjendur perballë kesaj deklarate oferta juaj refuzohet.

2. Nga verifikimi i kryer ne shtojces 8 (vetedeklarim) RRUGA URA ASFALTIM NR.2 ELBASAN nuk ka paraqitur 2 kamiona vetëshkarkues me 4 akse me kapacitet mbajtës minimumi 25 (njëzetepesë) ton, 2 automjetet e paraqitura jane Koka terheqese + gjysmerimorkio qe nuk plotesojne kushtin kamiona me 4 akse. (Si pasoje OE SHKELQIMI 07 nuk ka permbushur piken 2.3.2 praragrafi 3 , pasi ka paraqitur 1 nga 3 kamiona vetëshkarkues me 4 akse me kapacitet mbajtës minimumi 25 (njëzetepesë) ton).

II.5. Në datën 01.03.2024, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 507/2024 protokollit dhe me numër ankimi elektronik A/2024/3847 e BOE “Biba-X”

SHPK & “Bimak” SHPK me përfaqësues operatorin ekonomik “Biba-X” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr.REF-94268-01-31-2024, me objekt: “Blerje Asfalti” me fond limit 37.500.000 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 19.02.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kavajë.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga BOE “Biba-X” SHPK & “Bimak” SHPK.

II.5.1. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.507/2 prot, datë 01.03.2024 me arsyet e skualifikimit të cilat kundërshtohen nga ankimuesi. Konkretisht në ankesë pretendohet si vijon:

“[...]”

Së pari: Arsye refuzimi: “Nga verifikimi i kryer për dokumentat e tenderit të paraqitura në SPE operatori ekonomik BIBA-X nuk ka paraqitur shtojces 8 (vetedeklarim). Dokumenti i ngarkuar nuk hapet është i demtuar. Është detyrë dhe pergjegjesi e OE që të ngarkojë dokumentat në sistem në mënyrën e duhur dhe të sigurohet që cdo dokument i ngarkuar është i rregullt dhe hapet. “

Sqarojmë se dokumenti është i ngarkuar në sistem. Kjo është lehtësisht e verifikueshme. Pra arsyeja e parë e refuzimit nuk qëndron.

Së dyti: Arsye refuzimi: “Nga verifikimi i kryer për dokumentat e tenderit të paraqitura në SPE pjesëmarrësi në BOE, operatori BIMAK nuk përmbush pikën 2.3.7 të DST nuk është i pajisur me certificate ISO 9001:2015 për mallrat objekt prokurimi. Në fushat e aktivitetit për të cilat është certifikuar nuk përfshihen produktet bituminoze ose asfaltobetonet.”

Sqarojmë se sipas DST pika 2.3.7 thuhet se: “2.3.7 Operatorët ekonomikë, për të vërtetuar se mallrat, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, duhet të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Konkretisht:

- 1. ISO 9001:2015 (Standard për Sistemin e Menaxhimi të Cilësisë)/ekuivalente dhe e vlefshme.*
 - 2. ISO 14001:2015 (Standard për sistemin e menaxhimit të mjedisit)/ekuivalente e vlefshme.*
- Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.”*

Në asnjë moment shoqëria Bimak nuk ka marrë përsipër të prodhojë asfalt por vetëm transport në raport me përqindjen e tij në bashkim, sipas elementëve konkretë në përputhje me pikën 2.3.7.

Së treti: Arsye refuzimi: “Nga verifikimi i kryer në shtojces 8 (vetedeklarim) OE BIMAK nuk ka paraqitur asnjë kamiona vetëshkarkues me 4 akse me kapacitet mbajtës minimumi 25 (njëzetepesë) ton ose kamiona vetëshkarkues me 4 akse me kapacitet mbajtës minimumi 18

(tetëmbëdhjetë) ton., automjetet e paraqitura janë Koka terheqese + gjysmerimorkio qe nuk plotesojne kushtin kamiona me 4 akse. Si pasoje OE BIMAK nuk ka permbushur pjesen e tij ne pjesemarrjen ne BOE, pasi ka mare persiper te realizoje transport dhe nuk ka paraqitur asnje automjet transporti.”

Sqarojmë për KPP-në se mjetet e deklaruar janë mjete vetshkaruese gjysëm rimorkio me kazan vetshkarkues dhe jo gjysëm rimorkio sipas pretendimeve të KVO-së. Bashkimi i OE plotëson kualifikimin sipas pikës 2.3.1 të kapaciteteve teknike.

Gjithashtu pretendohet se “shoqëria “AL Asphalt” SHPK nuk përmbush kërkesat për tu kualifikuar pasi, sipas ekstraktit të QKB-së nuk e ka në objektin e veprimtarisë së tij objektin e kontratës që prokurohet” si dhe nuk plotëson kërkesën për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2023.

II.5.2. Në datën 11.03.2024 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 507/3 prot., shkresa e autoritetit kontraktor Nr.1130/2 prot., datë 07.03.2024, me objekt: “Informacion mbi procedurën me nr.aplikimi ankese online: A/2024/3847; nr.protokolli 507/2024, datë protokolli 2024-03-01”, bashkëngjitur vendimi i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave me nr. 1374/1 prot., datë 06.03.2024. Referuar vendimit të KSHA-së, rezulton se autoriteti kontraktor ka refuzuar pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, duke argumentuar si vijon:

“Lidhur me shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Biba-X” SHPK për arsyet e skualifikimit të këtij operatori ekonomik nga procedura me objekt: “Blerje asfali” KSHA vëren se:

- *BOE “Biba-X” SHPK & “Bimak” SHPK kanë paraqitur kundërshtitë e tyre për 3 nga 4 arsyet e skualifikimit të përcaktuara nga KVO, cka e bën ankesën e paplotë dhe argumentimi i fakteve nga BOE nuk i prek të gjitha arsyet e skualifikimit.*

Megjithatë KSHA do të marrë në shqyrtim të gjitha pretendimet e ngritura për arsyet e skualifikimit nga BOE “Biba-X” SHPK & “Bimak” SHPK.

**Lidhur me pikën e parë të skualifikimit “operatori ekonomik “Biba-X” SHPK nuk ka paraqitur shtojcën 8 (vetdeklarim)”.*

BOE “Biba-X” SHPK & “Bimak” SHPK në ankesën e tij për pikën e mësipërme nuk ka kundërshtuar faktet e përmendura nga KVO. KVO nuk hedh poshtë faktin që një dokument me emërtimin “Formulari_i_vetdeklarimit_Kavajë_19022024” është i ngarkuar në SPE, por ky dokument nuk hapet, pra është i dëmtuar, është dokument i pasaktë.

KSHA gjykon se është detyrë e operatorëve ekonomikë të paraqesin dokumentat e kërkuara në formatin e duhur dhe të sigurohen që këto dokumenta janë ngarkuar sic duhet dhe janë të aksesueshme. KSHA gjykon se, përsa kohë ky dokument nuk hapet ai nuk merret në shqyrtim, pasi nuk mund të shikohet përmbajtja e tij dhe si rrjedhojë “operatori ekonomik “Biba-X” SHPK nuk kaparaqitur shtojcën 8 (vetdeklarim)”. Theksojmë se shtojca 9 (vetdeklarimi) është dokument bazë mbi te cilin kryhet vleresimi i përmbushjes se kriterëve nga operatorët pjesemarrës ne procedurat e prokurimeve bazuar ne ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

KSHA i qendron arsyes se skualifikimit te dhene nga KVO dhe hedh poshte pretendimet e ngritura nga BOE "BIBA-X"& "BIMAK" sh.p.k.

* Lidhur me piken e dyte te skualifikimit pjesemarresi ne BOE, operatori BIMAK nuk permbush piken 2.3.7 te DST nuk eshte i pajisur me certificate iso 9001:2015 per mallrat objektprokurimi, ne fushat e aktivitetit per te cilat eshte certifikuar nuk perfshihen produktet bituminoze ose asfaltobetonet.

BOE "BIBA-X"& "BIMAK" sh.p.k, ne ankesen e saj per piken e mesiperme shprehimisht ka thene: "Ne asnjë moment shoqëria BIMAK nuk merr persiper te prodhoje asfalt por vetem transport ne raport me perqindjen e tij ne bashkim sipas elementeve konkret ne perputhje me piken 2.3.7"

KSHA nga argumentimi i BOE "BIBA-X"& "BIMAK" sh.p.k ne ankesen e tij veren se ky bashkim operatoresh nuk e kundërshton faktin qe operatori "BIMAK" sh.p.k nuk eshte i pajisur me certificate ISO 900.1:2015 per mallrat objekt prokurimi.

Në certifikatën ISO 900.1:2015 nr. AQS/S/97352023 janë përcaktuar fushat e aktivitetit për të cilat është certifikuar "Bimak" SHPK.

Ndertimi i punimeve civile dhe industriale (rruge, ura, ujesjellsa, kanalizime, punime elektrike, punime sinjalistike dhe siguri rrugore, gjelberim). Projektimi, ndertimi dhe mirembajtja e veprave elektrike per shperndarjen dhe transmetimin e energjise elektrike te tensionit te ulet, te mesem dhe te larte. Krijimi dhe mirembajtja e hapësirave te gjelberta publike dhe private. Nxjerrjen, punimin dhe shitjen e materialeve prej guri, te therrmuar dhe material inerte. Menaxhimin e imoianteve per traitimin e mbetieve.

Ne asnje pjese te saj nuk permendet prodhimi i produkteve te asfalto betonit, sic eshte objekti i prokurimit, pra konstatimet e KVO jane te sakta.

Ne dokumentat e ngarkuara ne SPE "kontrat bashkpunimi BIBA-X & BIMAK" ne pjesen e ndarjes se punimeve thuhet:

Shoqeria "BIMAK" sh.p.k merrte persiper te realizoje objektin e procedures se prokurimit ne masen 20% sipas tabelës se punimeve meposhte:

Nr	An.	Pershkrimi	Njesia
1	3.226	Asfalto beton guri kave	ton
2	An	Emulsion bituminoz I l/m2	kg
3	3.221	Bindes me granil guri kave	ton
4	An.	Transport asfalti	ton

Pra eshte e shprehur shume qarte qe shoqeria "BIMAK" sh.p.k. do te realizoje 20 % te zerave te punimeve te tabelës se mesiperme, merr persiper dhe prodhimin e asfaltobetonit, per te cilen nuk eshte e certifikuar.

Gjithashtu ne dokumentat e ngarkuara ne SPE "PREVENTIV_ BIMAK

Preventiv Oferte

Objekti: " Blerje asfalti "

Punime qe do te realizohen nga shoqeria "Bimak" sh.p.k

^{IN}	An.	Pershkrimi	Njesia	Sasia	Cmimi	Vlera
1	3.226	Asfalto beton guri kave	ton	691		
2	An	Emulsion bituminoz 1 l/m2	kg	-		
3	3.221	Binder me granil guri kave	ton			
4	An.	Transport asfalti	ton	468		
Vlera Totale						
T.V.SH						1
SHUMA ME T.V.SH						

Shoqëria "Bimak" SHPK sipas preventivit të mësipërm i cili është sa 20% e ofertës, ka marrë përsipër prodhimin e asfaltobetonit në masën 691 ton dhe transportin e asfaltit në masën 468 ton.

Faktet e mësipërme bien ndesh me argumentimin e BOE "Biba -X" SHPK & "Bimak" SHPK në të cilën shprehen se "Bimak" SHPK nuk merr përsipër të prodhojë asfalt por vetëm transport.

KSHA i qëndron arsyes së skualifikimit të dhënë nga KVO dhe hedh poshtë pretendimet e ngritura nga BOE "Biba -X" SHPK & "Bimak" SHPK.













**Lidhur me pikën e tretë të skualifikimit, BOE "Biba -X" SHPK & "Bimak" SHPK nuk kanë dhënë asnjë kundërshti. KSHA i qëndron vendimit të KVO.*

**Lidhur me pikën e katërt të skualifikimit: "Nga verifikimi i kryer ne shtojces 8 (vetedeklarim) OE BIMAK nuk ka paraqitur asnjë kamiona vetëshkarkues me 4 akse me kapacitet mbajtës minimumi 25 (njëzetepesë) ton ose kamiona vetëshkarkues me 4 akse me kapacitet mbajtës minimumi 18 (tetëmbëdhjetë) ton,, automjetet e paraqitura janë Koka terheqese + gjysmerimorkio qe nuk plotesojne kushtin kamiona me 4 akse. Si pasoje OE BIMAK nuk ka permbushur pjesen e tij ne pjesemarrjen ne BOE, pasi ka mare persiper te realizoje transport dhe nuk ka paraqitur asnjë automjet transporti."*

BOE "Biba -X" SHPK & "Bimak" SHPK në ankesën e saj për pikën e mësipërme shprehimisht ka thënë: "Sqarojmë për autoritetin kontraktor se mjetet e deklaruar janë mjete vetshkarkuese gjysëm rimorkio me kazan vetshkarkues dhe jo gjysëm rimorkio sipas pretendimeve të KVO-së. Bashkimi i OE plotëson kualifikimin sipas pikës 2.3.1 të kapaciteteve teknike.

KSHA nga argumentimi i BOE "BIBA-X"& "BIMAK" sh.p.k ne ankesen e tij veren se ky bashkim operatoresh nuk e kundërshton faktin qe operatori "BIMAK" nuk ka paraqitur kamiona vetëshkarkues me 4 akse me kapacitet mbajtës minimum 25 (njëzet e pese) ton ose kamiona vetëshkarkues me 4 akse me kapacitet mbajtës minimumi 18 (tetëmbëdhjetë) ton sic kerkohen ne piken 2.3.1 telcapaciteteve teknikete DST.

Sipas dokumentit "shtojca 8 Bimak", ne seksionin C Deklarate "Per disponimin e mjeteve pajisje/makineri te nevojshme per realizimin e punimeve object kontrate" OE "BIMAK" sh.p.k ka vetedeklaruar

Në pronësi				
Lloji i Mjetit	Targa	Nr. Lejes qarkullimit	Nr. Stasisë	Të tjera
1. Kamion vetshkarkues me 4 akse (koke terheqese + gjysmerimorkio vetshkarkues)	 + 	 + 	 77 + 	
2. Kamion vetshkarkues me 4 akse (koke terheqese + gjysmerimorkio vetshkarkues)	 + 	 + 	 5 + 	

Pra sic shihet “BIMAK” SHPK ka vetedeklaruar “kamion veteshkarkues me 4 akse (koke terheqese +gjysmerimorkio vetshkarkues”.

Por KSHA gjykon se mjetet e deklaruar nga “BIMAK” SHPK nuk pennbushin piken 2.3.1 te kapaciteteve teknike te DST, pasi koka terheqese+gjysmerimorkio jane me 5 akse dhe jo me 4 akse sic kerkohet, pra jemi ne kushtet e deklarimit te gabuar per te mos thene deklarim i rreme.

Gjithashtu ne argumentimin e BOE “BIBA-X” & “BIMAK” sh.p.k “Sqarojmë për autoritetin kontraktor se mjetet e deklaruar janë mjete vetshkarkuese gjysëm rimorkio me kazan vetshkarkues dhe jo gjysëm rimorkio sipas pretendimit tuaj, ngrihen dyshime qe KVO paska pretenduar qe jane gjysmerimorkio, ne nje kohe qe KVO ka bere vleresimin bazuar ne vetedeklarimin e operatorit ekonomik, dhe operatori ekonomik e ka deklaruar vete gjysmerimorkio.

KSHA nuk dyshon fare qe gjysmerimorkiot jane me kazan dhe trasportojne material por qe nuk permbushin kushtin e 4 akseve, pasi jane me 5 akse.

BOE duhet te paraqese oferten ne perputhje me te gjithe kushtet e percaktuara ne DST qe oferta e tyre te cilesohet e sukseshme.

KSHA i qendron arsyes se skualifikimit te dhene nga KVO dhe hedh poshte pretendimet e ngritura nga BOE “BIBA-X” & “BIMAK” sh.p.k.

*Lidhur me pretendimet e ngritura nga BOE “BIBA-X” & “BIMAK” sh.p.k për kualifikimin e padrejtë të OE “AL Asfalt” SHPK, KSHA vëren se:

-BOE “BIBA-X” & “BIMAK” sh.p.k ankohet se “AL-ASFALT” sh.p.k nuk ka sipas EKSTRAKTIT NGA QENDRA KOMBETARE E BIZNESIT nuk e ka ne objektin e veprimit te tij objektin e kontrates qe prokurohet....”

Per sa me siper pas shqyrtimit te Ekstraktit te shoqerise “AL ASFALT” sh.p.k, ne piken 9 te tij “Objekti i Aktivitetit” rrjeshti i nente shkruhet: “Prodhim Asfallo Beton”.

KSHA vëren që pretendimi i ngritur nga BOE “Biba-X” shpk & “Bimak” SHPK nuk qëndron.

1.1.1. - BOE “BIBA-X” & “BIMAK” SHPK ankohet se “AL-ASFALT” SHPK nuk ka shlyer taksat vendore për vitin 2023 ne pambushje të pikës 2.2.3 të DST Operatorët ekonomikë duhet të kenë shlyer të gjitha taksat vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit. ...”

Per sa me siper pas shqyrtimit te Ekstraktit te shoqerise “AL ASFALT”sh.p.k” ne piken 14 te tij “Vende të tjera të ushti-iinit të aktivitetit” jane te listuara adresat ku ushtron aktivitetin shoqeria “AL ASFALT”sh.p.k :

Durres Xhafzotaj XHAFZOTAJ Mjet tip Kamion Iveco, me targe xxxxx PL

Durres Xhafzotaj XHAFZOTAJ Mjet tip kamion Volvo, me targë XXXXX HU

Durres Xhafzotaj XHAFZOTAJ Kamion Terheqes Man XXXXXAR

Durres Xhafzotaj XHAFZOTAJ Kamion Man XXXXXXXXK

Durres Xhafzotaj XHAFZOTAJ Mjet tip Kamion VOLVO, me targe XXXXXXXXT

Durres Xhafzotaj XHAFZOTAJ Mjet Tip Kamion, Volvo, me targë XXXXXXXXH

Durres Shijak SHIJAK Mirëmbajtje me performancë Katër Rrugët-Pjezë, Xhafzotaj-Fllakë-Katund i Ri, Katër Rrugët-Shijak, ShijakMaminas, Shijak-Gjepala

Te gjitha adresat jane ne Bashkine Shijak, per te cilat shoqeria “AL ASFALT” sh.p.k ka deklaruar ne formularin e vetedeklarimit qe i ka shlyer taksat vendore per vitin 2023, gjithashtu per ta vertetuar vete deklarimin ne SPE ka paraqitur dhe dokumentin me emer “AL ASFALT Taksat vendore 2023” dokument i leshuar nga Bashkia Shijak qe verteton shlyejen e detyrimeve per taksat dhe tarifat vendore 2023.

Te gjitha adresat e tjera te permendura nga BOE “BIBA-X” & “BIMAK” sh.p.k, pas verifikimit te Ekstraktit thistorik jane adresa qe shoqeria “AL ASFALT” sh.p.k ka ushtruar aktivitetin perpara vitit 2023.

Konkretisht:

“Bashkia Durres —adresa eshte hequr me date 16/12/2022 me numer ceshtje CN -047952-12-22

"Bashkia Fier-adresa eshte hequr me date 25/10/2021 me numer ceshtje CN-803197-10-21 "

Bashkia Kavaje -adresa eshte hequr me date 16/12/2022 me numer ceshtje CN-047952-12-22

Bashkia Rrogozhine -adresa eshte hequr me date 16/12/2022 me numer ceshtje CN-047952-12-22

Bashkia Shkoder Njesia Administrative Velipoje- adresa eshte hequr me date 08/11/2019 me numer ceshtje CN-396964-11-19

Bashkia Bulqize- adresa eshte hequr me date 08/11/2019 me numer ceshtje CN-396964-11-19

Bashkia Tirane – Nuk ekziston asnjë adresë e ushtrimit të aktivitetit në Bashkine Tirane KSHA veren qe pretendimet e ngritura nga BOE “BIBA-X” & “BIMAK” sh.p.k nuk qendrojne. ...”.

II.5.3. Me qëllim gjykimin e ankesës së paraqitur, Komisioni i Prokurimit Publik gjykoi të nevojshëm zhvillimin e një seance dëgjimore me datë 08.04.2024, ora 11:00 me përfaqësues të

BOE “Biba-X” SHPK & “Bimak” SHPK dhe përfaqësues të autoritetit kontraktor Bashkia Kavajë, të cilët të disponojnë të dhënat për tu futur në llogaritë përkatëse në Sistemin e Prokurimit Elektronik. Palët u njoftuan për mbajtjen e kësaj seance nëpërmjet shkresës nr. 507/4 prot., datë 04.04.2024 të KPP-së. Kjo seancë u mbajt në datën dhe orën e njoftimit të sipërcituar në prani të përfaqësuesve të subjektit ankimues, të autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik. Në prani të palëve, përfaqësuesi i subjektit ankimues, u logua në llogarinë e tij të përdoruesit në SPE. Rezulton se subjektit “Biba-X” SHPK nuk i hapet *dokumenti me emërtimin “Formulari_i_vetdeklarimit_Kavajë_19022024*.

II.5.4. Për nevoja të hetimit administrativ të ankesës së BOE “Biba-X” SHPK & “Bimak” SHPK, në datën 24.04.2024, nëpërmjet shkresës nr. 507/9 prot., me objekt: “Kërkesë”, Komisioni i Prokurimit Publik kërkoi nga Agjencia e Prokurimit Publik si institucioni që administron sistemin e prokurimit elektronik, si dhe ka nxjerrë udhëzimet përkatëse për përdorimin e tij, informacion të hollësishëm mbi arsyet që bëjnë të pamundur hapjen në SPE të File me emërtimin: “FORMULAR_I_VETDEKLARIMIT_KAVAJE”, në ofertën e BOE “Biba-X” SHPK & “Bimak” SHPK.

II.5.5. Në datën 07.05.2024 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 507/12 prot., shkresa e Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 3295/1 prot., datë 02.05.2024 me objekt: “Kthim përgjigje”, ku jepen sqarimet si vijon:

“Agjencia e Prokurimit Publik mori në shqyrtim shkresën tuaj me nr. 507/9 prot., datë 24.04.2024, të protokolluar në institucion me nr. 3295 prot., datë 29.04.2024, me objekt: “Kërkesë”. Referuar pikës 4.1 “Vlerësimi i ofertave bazuar në metodën e paracaktuar të vlerësimit”, të Udhëzimit nr. 07, datë 30.07.2021 “Për mënyrën e zhvillimit të procedurës së prokurimit me mjete elektronike”, te paneli “Formulari i ofertës” ngarkohet vetëm oferta ekonomike nga operatorët ekonomikë, e cila enkriptohet duke mundësuar një ruajtje të informacionit të hedhur në sistem deri në hapjen e ofertave. Emërtimi i dokumentave të bashkëlidhur në këtë skedar merr një prapashtesë nga sistemi si psh “Formular_oferte1c671b98-1bd2-4f4a-81c2-fc232995b3b2.pdf”, në këto kushte APP bën të mundur vetëm procesin e dekriptimit për ofertën ekonomike në rastin kur është e enkriptuar. Ndërkohë në lidhje me dokumentin “FORMULAR_I_VETDEKLARIMIT_KAVAJE”, të ngarkuar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Biba-X” SHPK & “Bimak” SHPK në procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje asfalti” me numër reference REF-94268-01-31-2024, të zhvilluar nga autoriteti kontraktor Bashkia Kavajë, ju sqarojmë se emërtimi i dokumentit të sipërcituar nuk rezulton të ketë prapashtesën e dokumentit të enkriptuar. Në këto kushte, ky dokument nuk mund të dekriptohet nga APP. Sqarojmë se ngarkimi i dokumentave në sistem është përgjegjësi e operatorit ekonomik si dhe duhet të kryhet sipas udhëzimeve që APP ka publikuar lidhur me ngarkimin e dokumentave dhe ruajtjen e tyre në Sistemin e Prokurimit Elektronik.”

II.6. Në datën 05.03.2024, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 554/2024 protokolli dhe me numër ankimi elektronik A/2024/3864 e operatorit ekonomik “Rruga Ura Asfaltim Nr.2 Elbasan” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr.REF-94268-01-31-2024, me objekt: “Blerje Asfalti” me fond limit 37.500.000 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 19.02.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kavajë.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Rruga Ura Asfaltim Nr.2 Elbasan” SHPK.

II.6.1. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 554/2 date 06.03.2024, me arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “Rruga Ura Asfaltim Nr.2 Elbasan” SHPK, kundërshton me anë të ankesës me nr. 554 prot., datë 05.03.2024.

Konkretisht në ankesë pretendohet si vijon:

“1. Referuar arsyes se skualifikimit 1, nga ana e KVO dhe Autoritetit Kontraktor Bashkia Kavaje, ju bejme me dije se kemi bere nje lapsus ne momentin e polesimit te deklarates ne fjale, dmth gabim njerezor. Ne sistem elektronik nnder dokumentacionin plotesues kemi paraqitur te miratuar (te firomusr dhe vulosur) formularin e ofertes ekonomike sipas shtojces 1, listen e cmimeve te artikujve sipas shtojces 2, preventivin oferte, grafikun e levrimit te mallrave (i plotesuar sipas specifikimeve teknike te vendosura nga autoriteti kontraktor) ku per te gjitha keto kemi shpehur dakordesine tone per vijueshmerine e procedures se prokurimit dhe i gjithë ky dokumentacion ne llogjiken juridike te con ne permbushjen e pikes (gj) te nenit 26 te V.K.M nr. 285 date 19.52021, Per miratimin e rregullave te prokurimit publik, te ndryshuar, ku thuhet; gj) operatori ekonomik permbush specifikimet teknike, sipas kerkesave te percaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

Pra eshte marre persiper dhe eshte plotesuar i gjithë dokumentacioni per kualifikim, oferta ekonomike, grafiku i levrimit te mallrave (sipas specifikimeve teknike te vendosura nga autoriteti kontraktor), preventivi oferte, etj, ndersa ne momentin e hartimit te formularit te vetedeklarimit eshte bere gabimi njerezor i mesiper ku gabimisht eshte vendosur shenja X tek shenja JO, pra totalisht gabim njerezor.

Perderisa ne kemi marre pjese ne kete procedure dhe kemi ngarkuar te tere dokumentacionin do te thote qe i kemi te tera specifikimet teknike te nevojshme dhe permbushim te tera kushtet si dhe kemi marre persiper permbushjen ne kuader te grafikut.

Gjithashtu oferta jone ekonomike, duke qene je jemi renditur ne vendin e dyte, i kursen buxhetit te shtetit nje vlere te konsiderueshme prej 12,841,230 leke nga fondi limit.

2. Referuar asyes se skualifikimit 2, duke marre shkas vleresimin tuaj per skualifikim dhe referuar kriterëve te DST, paragrafit 2.3 Kapaciteti Teknik, pika 2.3.2, ku per permbushjen e kontrates kerkohen: minimalisht 6 (gjashte) kamiona veteshkarkues me 4 akse me kapacitet mbajtes minimumi 18 (tetembedhete) ton dhe minimalisht 3 (tre) kamiona veteshkarkues me 4 akse me kapacitet mbajtes minimumi 25 (njezetepese) ton dhe duke pare shtojcen 6 FORMULARI I SASISE DHE GRAFIKUT TE LEVRIMIT ne te cilen sasia totale e mallit te kontrates per transport qe kerkohet eshte 3468 ton, e shperndare ne nje periudhe 6 mujore ose 578 ton ne muaj. Sasi e cila, me mjetet e siguruar te lartpermendura, mund te sigurohet me vetem mesatarisht 3.16 rruge / muaj te secilit kamion, e shprehur ndryshe, secilit kamion i

takon mesatarisht te kryeje 1 rruge ngarkese ne 10 dite kalendarike per te realizuar volumet e kerkuara.

*E thene dhe ne nje tjeter forme, keto mjete (3 kamiona * 25 ton + 6 kamiona * 18 ton) kane kapacitet qe volumin e kerkuar prej 578 ton ne muaj te transportojne vetem ne nje dite pune.*

Pra duke pare kete parallogaritje te thjeshte dalim ne konkluzionin se mjetet e paraqitura jane mese te mjaftueshme per realizimin e kesaj kontrate dhe se keto mjete kane kapacitetin real shumefish me te larte se nevoja per te permbushur kete kontrate. Po ashtu e themi me plot bindje se duke pare relacionin me lart midis nevojës se materialit per transport dhe kapacitetit te mjeteve, pergjate zbatimit te kontrates, keto kamiona rreth 90 % te kohes llogjikisht i takon te jene te parkuara.

Pavaresisht sasise se madhe te kamionave te kerkuar ne krahesim me volumin e punes, duam te theksojme se makinerite e paraqitura nga ana jone do te jene plotesisht ne dispozicion te kontrates ne kuader te zbatimit te saj me perpikmeri.

Dua tju bej me dije dhe qartesoje se keto 2 kamiona veteshkarkues mbi 25 ton, jane te njejte me makinerite e kerkuara dhe e plotesojne kete kriter ne menyre te plote dhe funksionale.

Ju lutem, na qartesonini pak kur thoni qe mjetet e paraqitura nga ana jone nuk plotesojne kushtin kamiona me 4 akse. Me specifikisht cilin kusht nuk plotesojne konkretisht dhe cfare ndikimi ka ne mospermbushjen e zbatimit te kontrates si me poshte?

1- Kamion veteshkarkues (Trajler) me 4 akse me kapacitet mbajtes minimumi 25 ton;

- Lloji i Mjetit: TRAJLER - Koke Trajleri teheqese SCANIA me targe XXXXXNK te ciles do ti vihet ne dispozicion Gjysemrimorkio Minerva veteshkarkuese me 4 akse me kapacitet mbajtes 29.2 ton me targe AXXXX9.

2- Kamion veteshkarkues (Trajler) me 4 akse me kapacitet mbajtes minimumi 25 ton; - Lloji i Mjetit: TRAJLER - Koke Trajleri teheqese Mercedes Benz me targe XXXXXZH te ciles do ti vihet ne dispozicion Gjysemrimorkio Zorzi veteshkarkuese me 4 akse me kapacitet mbajtes 29.2 ton me targe AXXXX8.”

II.6.2. Nëpërmjet shkresës nr. 554/3, datë 21.03.2024 me objekt: “Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Rruga Ura Asfaltim Nr.2 Elbasan” SHPK”, Komisioni i Prokurimit Publik i kërkoi autoritetit kontraktor të dërgojë pranë Komisioni, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e shkresës, informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, ku të pasqyrohet procesi i shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave; të jepen argumentimet përkatëse mbi pretendimet e operatorit ekonomik “Rruga Ura Asfaltim Nr.2 Elbasan” SHPK si dhe vendimin e KSHA-së lidhur me trajtimin e ankesës së lartpërmendur.

II.6.3. Në datën 25.03.2024 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 554/4 prot., shkresa e autoritetit kontraktor Nr.1374/4 prot., datë 21.03.2024, me objekt: “Informacion mbi procedurën me nr.aplikimi ankese online: A/2024/3864; nr.protokolli 554/2024, datë protokolli 2024-03-05”, bashkëngjitur vendimi i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave me nr. 1374/3 prot., datë 19.03.2024.

Referuar vendimit të KSHA-së, rezulton se autoriteti kontraktor ka refuzuar pretendimet e operatorit ekonomik ankimes, duke argumentuar si vijon:

“Lidhur me arsyen e parë të skualifikimit, në ankesën e tij ankimuesi nuk ka sjellë asnjë kundërshti mbi konstatimet e KVO-së për vlerësimin e kryer, pra OE e pranon që ka bërë plotësimin gabim të shtojcës 8.

Theksojmë se shtojca 8 (vetëdeklarimi) është dokument bazë mbi të cilin kryhet vlerësimi i përmbshjes së kriterëve nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimeve bazuar në LPP.

KSHA gjykon se KVO ka vepruar drejt në vlerësimin e dokumentacionit të paraqitur nga OE “Rruga Ura Asfaltim Nr.2 Elbasan” SHPK dhe ka verifikuar përputhshmërinë e tyre me kërkesat e përcaktuara në DST. KSHA gjykon se një ofertë është e suksesshme vetëm nëse ajo i përmbush të gjitha kërkesat e përcaktuara në DST dhe nuk është kompetencë e KVO-së të përcaktojë se cila mangësi është gabim njerëzor apo dicka e tillë. Plotësimi gabim i shtojcës 8 e bën ofertën e OE “Rruga Ura Asfaltim Nr.2 Elbasan” SHPK të pakualifikueshme.

KSHA i qëndron arsyes së skualifikimit të dhënë nga KVO dhe hedh poshtë pretendimet e ngritura nga OE “Rruga Ura Asfaltim Nr.2 Elbasan” SHPK.

Lidhur me arsyen e dytë të skualifikimit të OE “Rruga Ura Asfaltim Nr.2 Elbasan” SHPK, në ankesën e tij ngre pretendime lidhur me numrin e kamioneve dhe specifikimet e tyre të përcaktuara në DST. Kujtojmë se OE “Rruga Ura Asfaltim Nr.2 Elbasan” SHPK ka patur të gjithë kohën e nevojshme procedurale për të kundërshtuar këto specifikime nëse i gjykonte të pasakta. [...].

KSHA gjykon se KVO ka vlerësuar drejt lidhur me makineritë e kërkuara në DST dhe ato të paraqitura nga OE “Rruga Ura Asfaltim Nr.2 Elbasan” SHPK. KSHA gjykon se ka diferencë ndërmjet “kamion vetëshkarkues me 4 akse me kapacitet mbajtës minimumi 25 ton” dhe “koka trajleri tërheqëse + gjysmërimorkio vetëshkarkues”, pasi nuk plotësohet nr i akseve të kamionit, koka e trajlit ka minimalisht 2 akse dhe gjysmërimorkio ka 3 akse, në total 5 akse dhe nuk përmbushet specifikimi i kërkuar. KSHA i qëndron arsyes së skualifikimit të dhënë nga KVO dhe hedh poshtë pretendimet e ngritura nga OE “Rruga Ura Asfaltim Nr.2 Elbasan” SHPK.”

II.7. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua, se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020 për prokurimin publik.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me arsyen e skualifikimit të BOE “Biba-X” SHPK & “Bimak” SHPK” SHPK se: *“Nga verifikimi i kryer për dokumentat e tenderit të paraqitura në SPE operatori ekonomik BIBA-X nuk ka paraqitur shtojcës 8 (vetëdeklarim). Dokumenti i ngarkuar nuk hapet është i demtuar. Është detyrë dhe përgjegjësi e OE që të ngarkojë dokumentat në sistem në mënyrë*

e duhur dhe te sigurohet qe cdo document i ngarkuar eshte i rregullt dhe hapet”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 7, tek “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit”, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;*
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);*
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;*
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;*
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;*
dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.*
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;*
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;*
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;*
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.*
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.*

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkm, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Ndërsa, në shtojcën 7, tek “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 1/a, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

III.1.2. Në shtojcën 8 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

Shtojca 8

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	----- -
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	----- ----

<i>Përfaqësuesi (emri):</i>	-----
<i>Telefoni:</i>	----- ---
<i>E-mail:</i>	----- -----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin***

<i>Emri i nënkontraktorit të propozuar</i>	<i>NIPT –i</i>	<i>Përqindja e nënkontraktimit</i>	<i>Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t’u nënkontraktuar</i>

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik***

<i>Emri (at) e subjekteve</i>	<i>NIPT-i</i>	<i>Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik</i>	<i>Specifiko konkretisht kapacitetin/et</i>

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata

Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

etj.

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Ne cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në mbështetje të Ligjit Nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklaram dhe garantoj se, deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

- 1. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;*
- 2. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;*
- 3. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;*
- 4. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;*
- 5. Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:
 - a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;*
 - b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.**
- 6. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):
 - a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;**

b) *Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).*

□

7. *Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:*

- a) *çmimet ;*
- b) *metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;*
- c) *qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,*
- d) *paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.*

8. *Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).*

9. *Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).*

C: DEKLARATA

Mbi Konfliktin e Interesit

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:

Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik

pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. **bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.**

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimi dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligjin Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

D: DEKLARATA

Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik _____ garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____ lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____ nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË

Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës:

Deklarata	Përgjigje
<i>Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e mallrave dhe grafikun e lëvrimin të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor.</i>	<i>Po [] Jo []</i>

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
<i>Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.</i>	<i><u>Punonjës</u> Po [] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve: _____ <u>Profili i punonjësve</u> _____ – <u>Makineri e mjete</u> Po [] Jo [] Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete: _____</i>
<i>Emri, Mbiemri _____ Firma _____ Vula _____ Data e dorëzimit të deklaratës _____</i>	

Ju lutemi sigurohuni që:


- **Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.**
- **Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.**


- Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak edhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.
- Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.

Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

- Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetdeklarimet në formularin përmbledhës të vetdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.
- Informacioni i pasqyruar në formularin e vetdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

III.1.3. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (S.P.E) për plotësimin e kriterit të mësipërm, bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues “Biba-X” SHPK & “Bimak” SHPK ka ngarkuar në SPE Filet me dokumentacionin si më poshtë:

 [kontrat bashkupunimi BIBA-X & BIMAK.pdf \(1,18 MB\)](#)

16.02.2024
13:51 

e cila përmban:

- Kontratë Bashkëpunimi Nr.Rep 737, Nr.Kol 255, datë 16.02.2024, ndërmjet operatorit ekonomik “Biba-X” SHPK dhe operatorit ekonomik “Bimak” SHPK, për procedurën e prokurimit objekt ankimi, ku në nenin 3 “Përqindjet për realizimin e objektit të procedurës së prokurimit si dhe ndarja e fitimit”, përcaktohet ndarja e pjesëve përkatëse, konkretisht, citojmë:


“Shoqëria “Biba-X” SHPK merr përsipër të realizojë objektin e procedurës së prokurimiti në masën 80% sipas tabelës së punimeve më poshtë:

Nr	An.	Pershkrimi	Njesia
1	3.226	Asfalto beton guri kave	ton
2	An	Emulsion bituminoz 1 l/m2	kg
3	3.221	Binder me granil guri kave	ton
4	An.	Transport asfalti	ton


“Shoqëria “Bimak” SHPK merr përsipër të realizojë objektin e procedurës së prokurimiti në masën 20% sipas tabelës së punimeve më poshtë:


Nr	An.	Pershkrimi	Njesia
1	3.226	Asfalto beton guri kave	ton
2	An	Emulsion bituminoz 1 l/m2	kg
3	3.221	Binder me granil guri kave	ton
4	An.	Transport asfalti	ton

 FORMULAR I VETDEKLARIMIT KAVAJE 19022024.pdf (815,7 kB)

19.02.2024
09:31 

- Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik “Biba”SHPK;

 formular vetdeklarimi BIMAK 19.02.2024.pdf (363,6 kB)

19.02.2024
09:31 

- Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik “Bimak” SHPK;

III.1.4. Në nenin 77 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhironja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve,

duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht : *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.”*

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: *“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”*

III.1.4. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.*

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënua për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënua me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënua me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të V, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7.Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”

III.1.5. Në nenin 88 pika 3 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se:

“Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.”

III.1.6. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një

procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.1.7. Në rastin konkret, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik vihet re, se në përmbushje të kriterit të mësipërm bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues ka dorëzuar secili prej tyre formularët përmbledhës të vetdeklarimit, por, sipas KVO-së dhe KSHA-së së autoritetit kontraktor formulari i vetdeklarimit të shoqërisë “Biba-X” SHPK, pjesë e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Biba-X” shpk & “Bimak” SHPK, *nuk hapet eshte i demtuar.*

Duke qënë në pamundësi të hapjes së dokumentit në fjalë edhe në logarinë e përdoruesit të KPP-së, me qëllim gjykimin e ankesës së paraqitur, Komisioni i Prokurimit Publik gjykoj të nevojshëm zhvillimin e një seance dëgjimore me datë 08.04.2024, ora 11:00 me përfaqësues të BOE “Biba-X” SHPK & “Bimak” SHPK dhe përfaqësues të autoritetit kontraktor Bashkia Kavajë, të cilët të disponojnë të dhënat për tu futur në llogaritë përkatëse në Sistemin e Prokurimit Elektronik. Palët u njoftuan për mbajtjen e kësaj seance nëpërmjet shkresës nr. 507/4 prot., datë 04.04.2024 të KPP-së. Kjo seancë u mbajt në datën dhe orën e njoftimit të sipërcituar në prani të përfaqësuesve të subjektit ankimues, të autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik. Në prani të palëve, përfaqësuesi i subjektit ankimues, u logua në llogarinë e tij të përdoruesit në SPE, por përsëri rezultoi se subjekti “Biba-X” SHPK nuk i hapet dokumenti me emërtimin *“Formulari_i_vetdeklarimit_Kavajë_19022024*, fakt i cili u pranua edhe nga vetë ankimuesi. Megjithatë për të qënë të sigurt për këtë konstatim, nëpërmjet shkresës nr. 507/9 prot., datë 24.04.2024 me objekt: “Kërkesë”, Komisioni i Prokurimit Publik kërkoi nga Agjencia e Prokurimit Publik si institucioni që administron sistemin e prokurimit elektronik, si dhe ka nxjerrë udhëzimet përkatëse për përdorimin e tij, informacion të hollësishëm mbi arsyet që bëjnë të pamundur hapjen në SPE të File me emërtimin: *“FORMULAR_I_VETDEKLARIMIT_KAVAJE”*, në ofertën e BOE “Biba-X” SHPK & “Bimak” SHPK.

Në përgjigje të kërkesës së KPP-së, nëpërmjet shkresës nr. 3295/1 prot., datë 02.05.2024 me objekt: “Kthim përgjigje”, protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 507/12 prot., Agjencia e Prokurimit Publik ka sqaruar se *“në lidhje me dokumentin “FORMULAR_I_VETDEKLARIMIT_KAVAJE”, të ngarkuar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Biba-X” SHPK & “Bimak” SHPK në procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje asfalti” me numër reference REF-94268-01-31-2024, të zhvilluar nga autoriteti kontraktor Bashkia Kavajë, ju sqarojmë se emërtimi i dokumentit të sipërcituar nuk rezulton të ketë parapashtesën e dokumentit të enkrituar. Në këto kushte, ky dokument nuk mund të dekriptohet nga APP. Sqarojmë se ngarkimi i dokumentave në sistem është përgjegjësi e operaorit ekonomik si dhe duhet të kryhet sipas udhëzimeve që APP ka publikuar lidhur me ngarkimin e dokumentave dhe ruajtjen e tyre në Sistemin e Prokurimit Elektronik.”*

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se dokumenti “FORMULAR_I_VETDEKLARIMIT_KAVAJE”, i cili përmban Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të shoqërisë “Biba-X” SHPK nuk mund të dekriptohet pasi ngarkimi ti tij në SPE nuk është bërë sipas udhëzimeve të APP-së. Gjykojmë se është barrë e operatorit ekonomik ankimues pjesëmarrës në procedurën e prokurimit objekti shqyrtimi, të paraqesë informacion dhe dokumentacion të saktë dhe vërtetojë se disponon kapacitetet teknike në përputhje me kërkesat e parashikuara në dokumentat e tenderit dhe legjislacionin në fuqi. Gjithashtu, bazuar edhe në nenin 82 pika 1 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, barra e provës për të vërtetuar plotësimin e kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor, bie mbi operatorin ekonomik, i cili në rastin konkret ka dështuar ta vërtetojë atë. Nuk mund të lejohet kualifikimi i një operatori ekonomik në rast se ai nuk plotëson kriteret e përcaktuara në dokumentat e tenderit.

Në këto kushte, duke qënë se Komisioni i Prokurimit Publik është në pamundësi të njohjen me përmbajtjen e këtij dokumenti, për faj të vetë ankimuesit, e konsideron të paplotësuar kërkesën për paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit nga ana e shoqërisë “Biba-X” SHPK.

Pretendimet e ankimuesit nuk qëndrojnë.

III.2. Lidhur me arsyen e skualifikimit të BOE “Biba-X” SHPK & “Bimak” SHPK se: “2. Nga verifikimi i kryer për dokumentat e tenderit të paraqitura në SPE pjesëmarrësi në BOE, operatori BIMAK nuk përmbush piken 2.3.7 të DST nuk është i pajisur me certificate ISO 9001:2015 për mallrat objekt prokurimi. Në fushat e aktivitetit për të cilat është certifikuar nuk përshihen produktet bituminoze ose asfaltobetonet”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 2.3.7 e dokumenteve të procedurës së mësipërme të prokurimit, rezulton se nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar plotësimi i kërkesave si më poshtë vijon:

“2.3.7 Operatorët ekonomikë, për të vërtetuar se mallrat, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, duhet të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Konkretisht:

- 1. ISO 9001:2015 (Standard për Sistemin e Menaxhimi të Cilësisë)/ekuivalente dhe e vlefshme.*
- 2. ISO 14001:2015 (Standard për sistemin e menaxhimit të mjedisit)/ekuivalente e vlefshme.*

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

III.2.2. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (S.P.E) për plotësimin e kriterit të mësipërm, bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues “Biba-X” SHPK & “Bimak” SHPK ka ngarkuar në SPE dokumentacionin si më poshtë:

- Kontratë Bashkëpunimi Nr.Rep 737, Nr.Kol 255, datë 16.02.2024, ndërmjet operatorit ekonomik “Biba-X” SHPK dhe operatorit ekonomik “Bimak” SHPK, për procedurën e prokurimit objekt ankimi, ku në nenin 3 “Përqindjet për realizimin e objektit të procedurës së prokurimit si dhe ndarja e fitimit”, përcaktohet ndarja e pjesëve përkatëse, konkretisht, citojmë:

“Shoqëria “Biba-X” SHPK merr përsipër të realizojë objektin e procedurës së prokurimiti në masën 80% sipas tabelës së punimeve më poshtë:

Nr	An.	Pershkrimi	Njesia
1	3.226	Asfalto beton guri kave	ton
2	An	Emulsion bituminoz 1 l/m2	kg
3	3.221	Binder me granil guri kave	ton
4	An.	Transport asfalti	ton

“Shoqëria “Bimak” SHPK merr përsipër të realizojë objektin e procedurës së prokurimiti në masën 20% sipas tabelës së punimeve më poshtë:

Nr	An.	Pershkrimi	Njesia
1	3.226	Asfalto beton guri kave	ton
2	An	Emulsion bituminoz 1 l/m2	kg
3	3.221	Binder me granil guri kave	ton
4	An.	Transport asfalti	ton

III.2.3. Lidhur me arsyen e skualifikimit të sipërcituar, BOE ankimes ka sqaruar se: *“Sqarojmë se sipas DST pika 2.3.7 thuhet se: “2.3.7 Operatorët ekonomikë, për të vërtetuar se mallrat, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, duhet të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Konkretisht:*

1. ISO 9001:2015 (Standard për Sistemin e Menaxhimi të Cilësisë)/ekuivalente dhe e vlefshme.
 2. ISO 14001:2015 (Standard për sistemin e menaxhimit të mjedisit)/ekuivalente e vlefshme.
- Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.”*

Në asnjë moment shoqëria Bimak nuk ka marrë përsipër të prodhojë asfalt por vetëm transport në raport me përqindjen e tij në bashkim, sipas elementëve konkretë në përputhje me pikën 2.3.7.”

III.2.4. Në nenin Neni 77 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Xhironja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.2.5. Ndërsa në nenin 79, po këtu thuhet se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

2. Autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dorëzimin e certifikatave ose dokumenteve të ngjashme, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë, veçanërisht sa i takon:

- a) garantimit të aksesit të personave me aftësi të kufizuara;*
- b) efikasitetit të energjisë;*
- c) sistemeve të menaxhimit mjedisor.*

3. Në rastet kur operatori ekonomik provon se nuk mund të pajiset me një certifikatë të tillë brenda një kohe të arsyeshme për arsye që nuk varen prej tij, autoriteti ose enti kontraktor mund të pranojë dokumente të tjera, nëpërmjet të cilave mund të provohet garantimi i standardeve të kërkuara.

4. Në çdo rast, certifikatat e kërkuara duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.

III.2.6. Në nenin Neni 92 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohet, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.

2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet.

3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.

III.2.7. Në nenin 88 pika 3 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se:

“Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të

madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.”

III.2.8. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.2.9. Në rastin konkret, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik vihet re, se në përmbushje të kriterit të mësipërm operatori ekonomik “Bimak” SHPK si pjesë e BOE “Biba-X” SHPK & “Bimak” shpk ka paraqitur dokumentacionin si vijon:

- Certifikatë Konformiteti, lëshuar nga kompania “AQScert” për shoqërinë “Bimak” SHPK për Standardin EN-ISO 9001-2015 për fushat e aktivitetit si vijon: *“Ndërtim i punimeve civile dhe industriale (rrugë, ura, ujësjellësa, kanalizime, pinime elektrike, punime sinjalistike dhe siguri rrugore, gjelbërim), .Projektimi, ndërtimi dhe mirëmbajtja e veprave elektrike për shpërndarjen dhe transmetimin e energjisë elektrike të tensionit të ulët, të mesëm dhe të lartë. Krijimi dhe mirëmbajtja e hapësirave të gjelbërta publike dhe private. Nxjerrjen, punimin dhe shitjen e materialeve prej guri, të thërmuar dhe material inerte. Menaxhimin e impianteve për trajtimin e mbetjeve.”*
- Certifikatë Konformiteti, lëshuar nga kompania “AQScert” për shoqërinë “Bimak” SHPK për Standardin EN-ISO 14001-2015 për fushat e aktivitetit si vijon: *“Ndërtimi i punimeve civile dhe industriale (rrugë, ura, ujësjellësa, kanalizime, pinime elektrike, punime sinjalistike dhe siguri rrugore, gjelbërim). Projektimi, ndërtimi dhe mirëmbajtja e veprave elektrike për shpërndarjen dhe transmetimin e energjisë*

elektrike të tensionit të ulët, të mesëm dhe të lartë. Krijimi dhe mirëmbajtja e hapësirave të gjelbërta publike dhe private. Nxjerrjen, punimin dhe shitjen e materialeve prej guri, të thërmuar dhe material inerte. Menaxhimin e impianteve për trajtimin e mbetjeve.”

III.2.10. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e cilësisë.

III.2.11. Në rastin konkret, për Autoritetin Kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik kryen aktivitetin objekt-prokurimi sipas standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare, vërtetuar kjo nëpërmjet paraqitjes të certifikatave të mësipërme. Rezulton se në përmbushje të kërkesës së autoritetit kontraktor për certifikatën *ISO 9001:2015 dhe ISO 14001:2015* shoqëria “Bimak” SHPK ka paraqitur certifikatat në fjalë dhe, në objektin e aktivitetit të shoqërisë janë përcaktuar fushat: *“Ndërtimi i punimeve civile dhe industriale (rrugë, ura, ujësjellësa, kanalizime, pinime elektrike, punime sinjalistike dhe siguri rrugore, gjelbërim). Projektimi, ndërtimi dhe mirëmbajtja e veprave elektrike për shpërndarjen dhe transmetimin e energjisë elektrike të tensionit të ulët, të mesëm dhe të lartë. Krijimi dhe mirëmbajtja e hapësirave të gjelbërta publike dhe private. Nxjerrjen, punimin dhe shitjen e materialeve prej guri, të thërmuar dhe material inerte. Menaxhimin e impianteve për trajtimin e mbetjeve”*, për të cilat nga ankimuesi pretendohet si vijon: *“[...] Në asnjë moment shoqëria “Bimak” shpk nuk ka marrë përsipër të prodhojë asfalt por vetëm transport në raport me përqindjen e tij në bashkim sipas elementëve konkret ,në përputhje me pikën 2.3.7.”*

Lidhur me argumentin e dhënë nga ankimuesi rezulton se në kontratën e bashkëpunimit të lidhur ndërmjet shoqërisë “Biba-X” SHPK dhe shoqërisë “Bimak” SHPK është parashikuar se *“Shoqëria “Biba-X” SHPK merr përsipër të realizojë objektin e procedurës së prokurimit në masën 80% sipas tabelës së punimeve më poshtë”* dhe *“Shoqëria “Bimak” SHPK merr përsipër të realizojë objektin e procedurës së prokurimit në masën 20% sipas tabelës së punimeve më poshtë:*

Nr	An.	Pershkrimi	Njesia
1	3.226	Asfalto beton guri kave	ton
2	An	Emulsion bituminoz 1 l/m2	kg
3	3.221	Binder me granil guri kave	ton
4	An.	Transport asfalti	ton

Pra rezulton se shoqëria “Bimak” SHPK ka marrë përsipër të realizojë objektin e procedurës në masën 20% për zërat “Asfalto beton guri kave”, “Emulsion bituminoz 1 l/m²”, “Binder me granil guri kave” dhe “Transport asfalti”, fakt i cili bie ndesh me pretendimin e ankimuesit se shoqëria “Bimak” shpk ka marrë përsipër vetëm transportin e asfaltit.

Sqarojmë se, referuar rregullave të prokurimit publik, përmbushja e kriterëve dhe kërkesave të autoritetit kontraktor duhet të bëhet nga secili anëtar i bashkimit në përputhje me përqindjen e objektit të marrë përsipër. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Biba-X” SHPK & “Bimak” SHPK, nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, pasi operatori ekonomik “Bimak” SHPK nuk e plotëson kërkesën për certifikatat ISO sipas përcaktimeve ligjore në fuqi dhe kërkesës së autoritetit kontraktor si më sipër cituar. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme, si edhe përbën kusht për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit.

Sqarojmë se, bazuar edhe në nenin 82 pika 1 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, barra e provës për të vërtetuar plotësimin e kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor, bie mbi operatorin ekonomik, i cili në rastin konkret ka dështuar ta vërtetojë atë. Nuk mund të lejohet kualifikimi i një operatori ekonomik në rast se ai ka mungesë dokumentacioni dhe nuk plotëson kriteret e përcaktuara nga vetë autoriteti kontraktor.

Pretendimet e ankimuesit nuk qëndrojnë.

III.3. Lidhur me arsyen e skualifikimit të BOE “Biba-X” SHPK & “Bimak” SHPK se: *“Nga verifikimi i kryer për dokumentat e tenderit të paraqitura në SPE, BOE nuk ka paraqitur shtojcën 2, sipas formatit të DST”*, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se BOE “Biba-X” SHPK & “Bimak” SHPK nuk ka paraqitur pretendime për këtë arsye skualifikimi.

III.3.1. Neni 24, pika 1, *“Komisioni i prokurimit Publik”* i Ligjit 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, parashikon shprehimisht se: *“Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me këtë ligj dhe akte të tjera ligjore brenda fushës së kompetencave të tij.”*

III.3.2. Neni 30, pika 1, *“Veprimtaria e Komisionit të Prokurimit Publik”* të Ligjit 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, parashikon shprehimisht se: *“Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e*

ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera. Shqyrtimi i ankesave për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar do të bëhet nga 3 anëtarë të Komisionit të Prokurimit Publik”.

III.3.3. Në nenin 110, pikat 3, 7 dhe 8 “Afatet për ankimim” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: “3. Në procedurat e prokurimit me faza mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit për këtë vendim. Në procedurat e prokurimit me faza nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.

7. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

8. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj. Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.”.

III.3.4. Në rastin konkret referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ si dhe raportit të auditit në sistemin e prokurimit publik rezulton, se autoriteti kontraktor ka paraqitur katër arsye skualifikimi për BOE ankimes, ndërsa në përmbajtjen e ankesës lidhur me vendimmarrjen e KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga BOE “Biba-X” SHPK & “Bimak” SHPK, ky i fundit ka kundërshtuar vetëm tre arsye skualifikimi, duke mos shfaqur asnjë pretendim në formularin e ankesës në lidhje me arsyen e skualifikimit nga autoriteti kontraktor, për sa i përket shtojcës 2. Gjithashtu, referuar edhe seancës dëgjimore të datës 08.04.2024 rezulton, se ky i fundit ka marrë dijeni për të gjitha arsyet e skualifikimit nga ana e autoritetit kontraktor.

Në nenin 110, pikat 3, “Afatet për ankimim” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “3. Në procedurat e prokurimit me faza mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit për këtë vendim. Në procedurat e prokurimit me faza nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.”.

Në rastin konkret KPP vëren, se BOE ankimes nuk i ka ezauruar të gjitha shkallët e ankimit në lidhje me pretendimet e tij mbi arsyet e skualifikimit nga autoriteti kontraktor, pasi për njëri prej arsyeve të skualifikimit (e cila rezulton e provuar nga materialet e fashikullit të shqyrtimit administrativ), nuk ka shfaqur pretendime në formularin e ankesës, duke sjellë në këtë mënyrë edhe rënien në dekadencë të së drejtës së tij dhe humbjen e afatit të ankimit në lidhje me këtë pretendim në kuptim të nenit 110, të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

III.4. Lidhur me arsyen e skualifikimit të BOE “Biba-X” SHPK & “Bimak” SHPK, se: “Nga verifikimi i kryer në shtojcës 8 (vetedeklarim) OE BIMAK nuk ka paraqitur asnjë kamion vetëshkarkues me 4 akse me kapacitet mbajtës minimumi 25 (njëzetepesë) ton ose kamion vetëshkarkues me 4 akse me kapacitet mbajtës minimumi 18 (tetëmbëdhjetë) ton., automjetet e

paraqitura janë Koka terheqese + gjysmerimorkio që nuk plotesojnë kushtin kamiona me 4 akse. Si pasoje OE BIMAK nuk ka permbushur pjesën e tij në pjesëmarrjen në BOE, pasi ka marrë persiper të realizojë transport dhe nuk ka paraqitur asnjë automjet transporti”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1. Në pikat 1 dhe 2 të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji.** Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t’i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

III.4.2. Ndërsa në nenin 92/3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

III.4.3. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.**

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese

brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 1 të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

III.4.4. Në nenin 39, pika 4 dhe gërma “d” e pikës 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se: “4. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

6. Për të provuar përshatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.[...]”

III.4.5. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa. Në pikën 1 dhe 6 të nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.** 2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe

deklarimin, si më poshtë vijon: i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti; 6. **Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton, se për përmbushjen e kërkesave për disponimin e automjeteve operatori ekonomik “Bimak” SHPK ka dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit (shtojca 8), në të cilit ka deklaruar se disponon mjetet në pronësi:

1. Kamion vetshkarkues me 4 akse (koka tërheqëse+ gjysëmrimorkio vetshkarkuese) me targë AXXXXR+ AXXXXX
2. Kamion vetshkarkues me 4 akse (koka tërheqëse+ gjysëmrimorkio vetshkarkuese) me targë AXXXXV+ AXXXX8

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE, Komisioni konstaton, se operatori ekonomik “Bimak” SHPK në dorëzimin e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ka plotësuar të dhënat e mundshme që parashikon formulari përmbledhës, konkretisht ka deklaruar targat, nr. e lejeve të qarkullimit, nr. e shasisë së mjeteve. Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor në fazën e vlerësimit procedural në të cilin ndodhet aktualisht procedura e prokurimit objekt-ankimi, për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, duhet t’i referohet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas rubrikave të aksesueshme elektronikisht nga autoriteti kontraktor dhe kërkesës për **dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të VKM-së, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.**

Akoma më tej, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është me vend të theksojë rolin e posaçëm që ka autoriteti kontraktor, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti/enti kontraktor ai që duhet t’i kërkojë **ofertuesit të kualifikuar, i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të VKM-së 285.** Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin, për t’u siguruar nëse cilësia e shërbimit, punës apo mallit është e njëjtë me cilësinë e premtuar në momentin apo fazën e ofertimit. Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Bimak” SHPK, pjesë e BOE “Biba-X” SHPK & “Bimak” SHPK në procedurën e prokurimit, plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm për këtë fazë.

Pretendimi i ankimuesit qëndron.

III.5. Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik “Rruga Ura Asfaltim Nr.2 Elbasan” SHPK se: “1. Nga verifikimi I kryer per dokumentat e tenderit te paraqitura ne SPE

dhe ne shtojces 8 (vetedeklarim) operatori ekonomik RRUGA URA ASFALTIM NR.2 ELBASAN ne

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË

Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës:

Deklarata	Përgjigje
<i>Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojmë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e mallrave dhe grafikun e levrimit të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor.</i>	<i>Po [] Jo [X]</i>

Ne vetedeklarimin e operatorit ekonomik RRUGA URA ASFALTIM NR.2 ELBASAN , shenja eshte vene te JO, duke vetedeklaruar se nuk I ploteson te gjitha specifikimet teknike sic udhëzohet ne dokumentat e tenderit dhe nuk marrin persiper te realizojne objektin ne perputhje me Listen e mallrave dhe grafikun e levrimit te percaktuar nga Autoriteti Kontraktor.

Te gjendur perballë kesaj deklarate oferta juaj refuzohet.

Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.5.1. Në shtojcën 5 “Formulari i specifikimeve teknike”, të dokumentave të tenderit të publikuara në SPE, është parashikuar si vijon:

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

ASFALTO BETONI GURE KAVE Duhet te jete i pregatitur nga lendet lidhese bitum, cakull ne masen 40% dhe rere ne masen 60%.Te jete I prodhuarnga material gurore i thyer me permasat nga 5-20mm. me permbajtje bitumi jo me pak se 4.5%,densiteti 2.2gr/cm³dhe bitum 50 70.Materiali i gurit qe do teperdoret per granilin e gurit, . Temperatura e Asfaltit ne ne momentin e hedhjes ne objekt duhet te jete 150 grade.Ne perzierjen e gatshme te asfalto betonit nuk lejohet te kete kokrriza te pa mbuluara me bitum. Bitumi qe perdoret per prodhimin e asfaltobetonit si dhe ne asfaltimet e tjera me depertim ose trajtim siperfaqesor, duhet te plotesoje kerkesat e Stash 660-87 ose te STASH CNR Nr. 1996 Karakteristika per pranim”. Ne kohe te nxehte (vere) keshillohet perdorimi i bitumit me depertim (penetrim) 80 deri 120 ose me pike zbutje 45 deri 50°C, ndersa ne pranvere e vjeshte bitum me depertim 120 deri 200 ose pike zbutje 40 deri 45°C.

BITUMEDDuhet te jete cilesore me nje dozim 3.8 per m² dhe i zbatuar ne te nxeht.Te hollohet me 20/30 % uji.

BINDER Duhet te jete i pregatitur nga lendet lidhese bitum, cakull ne masen 60% dhe rere ne masen 40%.Te jete I prodhuarnga material gurore i thyer me permasat nga 5-20mm. me permbajtje bitumi jo me pak se 4.5%,densiteti 2.2gr/cm³dhe bitum 50 70.Materiali i gurit qe do teperdoret per granilin e gurit, . Temperatura e Asfaltit ne ne momentin e hedhjes ne objekt duhet te jete 150 grade.Ne perzierjen e gatshme te binderi nuk lejohet te kete kokrriza te pa mbuluara me bitum. `Bitumi qe perdoret per prodhimin e asfaltobetonit si dhe ne asfaltimet e tjera me depertim ose trajtim siperfaqesor, duhet te plotesoje kerkesat e Stash 660-87 ose te STASH CNR Nr. 1996 Karakteristika per pranim”. Ne kohe te nxehte (vere) keshillohet perdorimi i bitumit me depertim (penetrim) 80 deri 120 ose me pike zbutje 45 deri 50°C, ndersa ne pranvere e vjeshte bitum me depertim 120 deri 200 ose pike zbutje 40 deri 45°C.

III.5.2.Në shtojcën 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 2.1.a të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

III.5.3. Në shtojcën 8 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi në Pjesën III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit, është parashikuar:

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË

Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës:

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha	Po [] Jo []

specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e mallrave dhe grafikun e lëvrimit të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor.	
---	--

III.5.4. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezultojnë, se operatori ekonomik “Rruga Ura Asfaltim Nr.2 Elbasan” SHPK, në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit të plotësuar nga operatori ekonomik “Rruga Ura Asfaltim Nr.2 Elbasan” SHPK ku pika A: DEKLARATË Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës”, është plotësuar si më poshtë:

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË

Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës:

Deklarata	Përgjigje
<i>Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojmë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e mallrave dhe grafikun e lëvrimit të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor.</i>	<i>Po [] Jo [X]</i>

III.5.5. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: *Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.5.6. Në nenin 3 Parime të përgjithshme: *“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me*

qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.5.7. Në nenin 36 “Specifikimet teknike” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se:

“1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi

ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor

III.5.8. Në nenin 77, “Kërkesat për kualifikim” të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhironja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”.

III.5.9. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.**

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 1 të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqiturnë procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

III.5.10. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

III.5.11. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga shoqëria “Rruga Ura Asfaltim Nr.2 Elbasan” SHPK, rezulton se në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, të plotësuar nga ky operator, është zgjedhur varianti “Jo” përsa i përket deklaratës: *“Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojmë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e mallrave dhe grafikun e lëvrimit të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor”,* gjë e cila nuk e detyron operatorin ekonomik të përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor, duke e vënë në vështirësi autoritetin kontraktor për zbatimin e kontratës, në kushtet kur ofertuesi ka mohuar përmbushjen e specifikimeve teknike dhe grafikun e lëvrimit.

Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin se dokumentacioni dhe informacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe nuk mund të konsiderohet i vlefshëm e, rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Sa më sipër, KPP sqaron se, mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme.

Operatori ekonomik ankimues duhej të dorëzonte të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin

oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion. Dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe nuk mund të konsiderohet i vlefshëm.

Pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

III.6. Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik “Rruga Ura Asfaltim Nr.2 Elbasan” SHPK se: “Nga verifikimi i kryer në shtojcën 8 (vetedeklarim) RRUGA URA ASFALTIM NR.2 ELBASAN nuk ka paraqitur 2 kamiona vetëshkarkues me 4 akse me kapacitet mbajtës minimumi 25 (njëzetepesë) ton, 2 automjetet e paraqitura janë Koka terheqese + gjysmerimorkio që nuk plotësojnë kushtin kamiona me 4 akse”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.6.1. Në shtojcën 8 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

Shtojca 8

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

II. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	----- -
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	----- ----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	----- ---
E-mail:	----- -----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- **Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- **Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit**A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT****Deklarata**

Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

etj.

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për

të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Ne cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në mbështetje të Ligjit Nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklaram dhe garantoj se, deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

10. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;
11. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;
12. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;
13. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;
14. Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:
 - c) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;
 - d) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.
15. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):
 - a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;
 - b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).
16. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:

- e) çmimet ;
- f) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
- g) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
- h) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

17. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).

18. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

C: DEKLARATA

Mbi Konfliktin e Interesit

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:

Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë.

Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. **bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.**

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimi dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligjin Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

D: DEKLARATA

Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik _____ garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____ lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____ nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË

Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikon e realizimit të objektit të kontratës:

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojmë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e	Po [] Jo []

<i>mallrave dhe grafikun e lëvrimit të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor.</i>	
---	--

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
<p><i>Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:</i></p> <p><i>Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.</i></p>	<p><u>Punonjës</u></p> <p><i>Po [] Jo []</i></p> <p><i>Nëse, po, numri i punonjësve:</i></p> <hr/> <p><i>Profili i punonjësve</i></p> <hr/> <p>–</p> <p><u>Makineri e mjete</u></p> <p><i>Po [] Jo []</i></p> <p><i>Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:</i></p> <hr/>
<p><i>Emri, Mbiemri _____</i></p> <p><i>Firma _____</i></p> <p><i>Vula _____</i></p> <p><i>Data e dorëzimit të deklaratës _____</i></p>	

Ju lutemi sigurohuni që:

- *Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.*
- *Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.*
- *Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak edhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.*
- *Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.*

Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

- *Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike.*

Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

- ***Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.***

III.6.2. Në shtojcën 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 2.3.2 “Kapaciteti teknik” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi , nga ana e autoritetit kontraktor është përcaktohet kriteri si më poshtë:

2.3.2. *Për të provuar kapacitetet teknike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi për mjetet, që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion për të përmbushur kontratën. Konkretisht, mjetet e nevojshme për të përmbushur kontratën janë :*

-minimalisht 6 (gjashtë) kamiona vetëshkarkues me 4 akse me kapacitet mbajtës minimumi 18 (tetëmbëdhjetë) ton,

- minimalisht 3 (tre) kamiona vetëshkarkues me 4 akse me kapacitet mbajtës minimumi 25 (njëzetepesë) ton

Për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publike, operatori ekonomik ofertues, duhet të disponojë leje e qarkullimit, certifikata e pronësisë, certifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, taksat vjetore, leja e transportit, foto perkatëse ballore dhe anesore.

Për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publike që merren me qira, operatori ekonomik ofertues, duhet të disponojë kontratë noteriale e qirasë e vlefshme gjatë gjithë afatit të realizimit të kontratës objekt prokurimi. Bashkangjitur kontratës së qirase duhet të jenë leja e qarkullimit, certifikata e pronësisë, certifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, taksat vjetore, leja e transportit, foto perkatëse ballore dhe anesore.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Për të përmbushur kërkesat e mësipërme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues i përcaktuar mesipër duhet të paraqitet pranë Autoritetit Kontraktor vetëm nga operatori ekonomik i shpallur fitues përpara publikimi te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afatave te ankimit.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

III.6.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “Rruga Ura Asfaltim Nr.2 Elbasan” SHPK, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar:

- Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit (shtojca 8) nga operatori ekonomik “Rruga Ura Asfaltim Nr.2 Elbasan” SHPK, ku në Deklaratën B për disponimin e makinerive të nevojshme është plotësuar si vijon:

Makineri e mjete:

Po [X] Jo []

Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:

- Fabrikë Asfalti, në pronësi të shoqëria "Rruga Ura Asfaltim Nr.2 Elbasan" sh.a shoqëruar me dokumentacionin e pronësisë si më poshtë:

Fatura doganore nr.4/14 date 17.03.2001, Shasia 4000
Fatura doganore nr.5/1 date 16.03.2001
Fatura doganore nr.6/1 date 15.03.2001
Fatura doganore nr.7/1 date 14.03.2001
Fatura doganore nr.8/1 date 13.03.2001
Fatura doganore nr.9/1 date 12.03.2001
Fatura doganore nr.10/1 date 11.03.2001 Shasia 3200
Fatura doganore nr.11/1 date 10.04.2001 Shasia 4000
Fatura doganore nr.12/1 date 09.04.2001 Shasia 4000
Fatura doganore nr.13/1 date 08.04.2001 Shasia 4000
Fatura doganore nr.14/1 date 07.04.2001 Shasia 4000
Fatura doganore nr.15/1 date 06.04.2001 Shasia 4000
Fatura doganore nr.16/1 date 05.04.2001 Shasia 4000
Fatura doganore nr.17/1 date 04.04.2001 Shasia 4000
Fatura doganore nr.18/1 date 03.04.2001 Shasia 4000
Fatura doganore nr.19/1 date 02.04.2001 Shasia 4000

Foto, planimetria (planvendosje), leje mjedisore kodit III.1.B dhe PN-4177-11-2016, Akti i miratimit të lejes mjedisore nr.1007 prot, date 11.03.2015 dhe numer identifikimi i lejes 1007, Çertifikate ISO 9001:2015, Raport monitorimi mjedisor, karta teknologjike + raport etj.

Mjetet në pronësi:

- Kamion vetëshkarkues (Trajler) me 4 akse me kapacitet mbajtës minimumi 25 ton;

- Lloji i Mjetit: TRAJLER - Gjysemrimorkio Minerva vetëshkarkues me 4 akse me kapacitet mbajtës 29.2 ton me targe AIR349 të cilës do vihet në dispozicion Koka trajlerit teheqese SCANIA me targe AIR349K.

- Targa: AIR349

- Nr. Lejes qarkullimit: EL0000000000

- Nr. Shasisë: Z10000000000000000000

- Të tjera: 29.2 ton

- Pronësia: "Rruga Ura Asfaltim Nr.2 Elbasan" sh.a

Mjetet me qira:

- Kamion vetëshkarkues (Trajler) me 4 akse me kapacitet mbajtës minimumi 25 ton;

- Lloji i Mjetit: TRAJLER - Koke Trajlere teheqese SCANIA me targe AIR349K të cilës do të vihet në dispozicion Gjysemrimorkio Minerva vetëshkarkuese me 4 akse me kapacitet mbajtës 29.2 ton me targe AIR349K.

- Targa e mjetit: AIR349K

- Nr. Lejes qarkullimit: EL0000000000



- Shasia: [redacted]
- Të tjera: [redacted] ton
- Nr.Kontrates se qirase (noterise):Nr.Rep 922, Nr.Kol 549, Qiradhënës ALBSTONE sh.p.k dhe Qiramarrës Rruga Ura Asfaltim Nr.2 Elbasan sh.a.
- Afati i kontratës qirasë(data e fillimit dhe mbarimit): Nga data e nenshkrimit te kontrates noteriale te qirase 17.02.2024 per nje periudhe deri ne realizimin e plote te kontrates , dhe dorezimin tek investitori. Ky afat fillon me date 17.02.2024 me lidhjen e kontrates noteriale te qirase.

Mjetet me qira:

- Kamion vetëshkarkues me 4 akse me kapacitet mbajtës minimumi 18 (tetëmbëdhjetë) ton,


- Lloji i Mjetit: Kamion vetëshkarkues me 4 akse
- Targa e mjetit: [redacted]
- Nr. Lejes qarkullimit: [redacted]
- Shasia: [redacted]
- Të tjera: 20 ton
- Nr.Kontrates se qirase (noterise):Nr.Rep 549, Nr.Kol 549, Qiradhënës [redacted] sh.p.k dhe Qiramarrës Rruga Ura Asfaltim Nr.2 Elbasan sh.a.
- Afati i kontratës qirasë(data e fillimit dhe mbarimit): Nga data e nenshkrimit te kontrates noteriale te qirase 17.02.2024 per nje periudhe deri ne realizimin e plote te kontrates , dhe dorezimin tek investitori. Ky afat fillon me date 17.02.2024 me lidhjen e kontrates noteriale te qirase.

Mjetet me qira:

- Kamion vetëshkarkues me 4 akse me kapacitet mbajtës minimumi 18 (tetëmbëdhjetë) ton,

- Lloji i Mjetit: Kamion vetëshkarkues me 4 akse
- Targa e mjetit: [redacted]
- Nr. Lejes qarkullimit: [redacted]
- Shasia: [redacted]
- Të tjera: [redacted] ton
- Nr.Kontrates se qirase (noterise):Nr.Rep 923, Nr.Kol 549, Qiradhënës [redacted] sh.p.k dhe Qiramarrës Rruga Ura Asfaltim Nr.2 Elbasan sh.a.
- Afati i kontratës qirasë(data e fillimit dhe mbarimit): Nga data e nenshkrimit te kontrates noteriale te qirase 17.02.2024 per nje periudhe deri ne realizimin e plote te kontrates , dhe dorezimin tek investitori. Ky afat fillon me date 17.02.2024 me lidhjen e kontrates noteriale te qirase.



	<ul style="list-style-type: none"> • Kamion vetëshkarkues me 4 akse me kapacitet mbajtës minimumi 18 (tetëmbëdhjetë) ton, - Lloji i Mjetit: Kamion vetëshkarkues me 4 akse - Targa e mjetit: A... - Nr. Lejes qarkullimit: ... - Shasia: W... - Të tjera: 22 ton - Nr.Kontrates se qirase (noterise):Nr.Rep ... , Nr.Kol ... , Qiradhënës ... sh.p.k dhe Qiramarrës Rruga Ura Asfaltim Nr.2 Elbasan sh.a. - Afati i kontratës qirasë(data e fillimit dhe mbarimit): Nga data e nenshkrimit te kontrates noteriale te qirase 17.02.2024 per nje periudhe deri ne realizimin e plote te kontrates , dhe dorezimin tek investitori. Ky afat fillon me date 17.02.2024 me lidhjen e kontrates noteriale te qirase.
	<ul style="list-style-type: none"> • Kamion vetëshkarkues (Trajler) me 4 akse me kapacitet mbajtës minimumi 25 ton; - Lloji i Mjetit: TRAJLER - Koke Trajleri teheqese Mercedes Benz me targe ... te ciles do ti vihet ne dispozicion Gjysemrimorkio Zorzi veteshkarkuese me 4 akse me kapacitet mbajtes 29.2 ton me targe AGR478. - Targa: ... - Nr. Lejes qarkullimit: ... - Nr. Shasisë: W... - Të tjera: 22 ton - Nr.Kontrates se qirase (noterise):Nr.Rep ... , Nr.Kol ... , Qiradhënës ... sh.p.k dhe Qiramarrës Rruga Ura Asfaltim Nr.2 Elbasan sh.a. - Afati i kontratës qirasë(data e fillimit dhe mbarimit): Nga data e nenshkrimit te kontrates noteriale te qirase 17.02.2024 per nje periudhe deri ne realizimin e plote te kontrates , dhe dorezimin tek investitori. Ky afat fillon me date 17.02.2024 me lidhjen e kontrates noteriale te qirase
	<ul style="list-style-type: none"> • Kamion vetëshkarkues (Trajler) me 4 akse me kapacitet mbajtës minimumi 25 ton; - Lloji i Mjetit: TRAJLER - Gjysemrimorkio Zorzi veteshkarkues me 4 akse me kapacitet mbajtes 29.2 ton me targe AGR478 te ciles do vihet ne dispozicion Koka trajlerit teheqese Mercedes Benz me targe ... - Targa: A... - Nr. Lejes qarkullimit: K... - Nr. Shasisë: Z... - Të tjera: 22 ton - Nr.Kontrates se qirase (noterise):Nr.Rep ... , Nr.Kol ... , Qiradhënës ... sh.p.k dhe Qiramarrës Rruga Ura

Asfaltim Nr.2 Elbasan sh.a.

- **Afati i kontratës qerasë(data e fillimit dhe mbarimit):**
Nga data e nenshkrimit te kontrates noteriale te qirase 17.02.2024 per nje periudhe deri ne realizimin e plote te kontrates , dhe dorezimin tek investitori. Ky afat fillon me date 17.02.2024 me lidhjen e kontrates noteriale te qirase

Mjetet me qira:

- **Kamion vetëshkarkues me 4 akse me kapacitet mbajtës minimumi 18 (tetëmbëdhjetë) ton,**
- **Lloji i Mjetit:** Kamion vetëshkarkues me 4 akse
- **Targa e mjetit:** [blurred]
- **Nr. Lejes qarkullimit:** T [blurred]
- **Shasia:** YV [blurred]
- **Të tjera:** 2.1 ton
- **Nr.Kontrates se qirase (noterise):** Nr.Rep. 3, Nr.Kol. 17, Qiradhënës [blurred] sh.p.k dhe Qiramarrës Rruga Ura Asfaltim Nr.2 Elbasan sh.a.
- **Afati i kontratës qirasë(data e fillimit dhe mbarimit):**
Nga data e nenshkrimit te kontrates noteriale te qirase 19.02.2024 per nje periudhe deri ne realizimin e plote te kontrates , dhe dorezimin tek investitori. Ky afat fillon me date 19.02.2024 me lidhjen e kontrates noteriale te qirase.

- **Kamion vetëshkarkues me 4 akse me kapacitet mbajtës minimumi 18 (tetëmbëdhjetë) ton,**
- **Lloji i Mjetit:** Kamion vetëshkarkues me 4 akse
- **Targa e mjetit:** [blurred]
- **Nr. Lejes qarkullimit:** T [blurred]
- **Shasia:** YV [blurred]
- **Të tjera:** [blurred]
- **Nr.Kontrates se qirase (noterise):** Nr.Rep. 2, Nr.Kol. 16, Qiradhënës [blurred] sh.p.k dhe Qiramarrës Rruga Ura Asfaltim Nr.2 Elbasan sh.a.
- **Afati i kontratës qirasë(data e fillimit dhe mbarimit):**
Nga data e nenshkrimit te kontrates noteriale te qirase 19.02.2024 per nje periudhe deri ne realizimin e plote te kontrates , dhe dorezimin tek investitori. Ky afat fillon me date 19.02.2024 me lidhjen e kontrates noteriale te qirase.



	<ul style="list-style-type: none"> • Kamion vetëshkarkues me 4 akse me kapacitet mbajtës minimumi 18 (tetëmbëdhjetë) ton, - Lloji i Mjetit: Kamion vetëshkarkues me 4 akse - Targa e mjetit: ... - Nr. Lejes qarkullimit: TR... - Shasia: YV... - Të tjera: ... 4.2 ton - Nr.Kontrates se qirase (noterise): Nr.Rep. ... , Nr.Kol. ... , Qiradhënës ... -I sh.p.k dhe Qiramarrës Rruga Ura Asfaltim Nr.2 Elbasan sh.a. - Afati i kontratës qirasë(data e fillimit dhe mbarimit): Nga data e nenshkrimimit te kontrates noteriale te qirase 19.02.2024 per nje periudhe deri ne realizimin e plote te kontrates , dhe dorezimin tek investitori. Ky afat fillon me date 19.02.2024 me lidhjen e kontrates noteriale te qirase. <ul style="list-style-type: none"> • Kamion vetëshkarkues (Trajler) me 4 akse me kapacitet mbajtës minimumi 25 ton - Lloji i Mjetit: Kamion vetëshkarkues me 4 akse - Targa e mjetit: A - Nr. Lejes qarkullimit: TF - Shasia: Y - Të tjera: ... 1 ton - Nr.Kontrates se qirase (noterise):Nr.Rep. ... , Nr.Kol. ... , Qiradhënës ... -I sh.p.k dhe Qiramarrës Rruga Ura Asfaltim Nr.2 Elbasan sh.a. - Afati i kontratës qirasë(data e fillimit dhe mbarimit): Nga data e nenshkrimimit te kontrates noteriale te qirase 19.02.2024 per nje periudhe deri ne realizimin e plote te kontrates , dhe dorezimin tek investitori. Ky afat fillon me date 19.02.2024 me lidhjen e kontrates noteriale te qirase <hr/> <p>-Vërtetim që shoqëria "Rruga Ura Asfaltim Nr.2 Elbasan" sh.a ka paguar (shlyer) taksat vendore per vitin 2023.</p>
--	--

III.6.4. Në nenin 77, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer

shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalohet dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.

III.6.5. Në pikat 1 dhe 2 të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji.** Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe,

sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

III.6.6. Ndërsa në nenin 92/3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

III.6.7. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.**

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarinimin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 1 të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqiturnë procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

III.6.8. Në nenin 39, pika 4 dhe gërma “d” e pikës 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se: “4. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.[...]”

III.6.9. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriteve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa. Në pikën 1 dhe 6 të nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: **“Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla. 2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon: i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti; 6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton, se për përmbushjen e kriterit 2.3.2 “Kapaciteti teknik” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, për disponimin e automjeteve si më sipër cituar, operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit (shtojca 8), në të cilit ka deklaruar se disponon mjetet e kërkuara në dokumentat e tenderit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE, Komisioni konstaton, se operatori ekonomik ankimues në dorëzimin e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ka plotësuar të gjitha të dhënat e mundshme që parashikon formulari përmbledhës, konkretisht ka deklaruar targën dhe nr. e shasisë së mjetit, tonazhin, nr e lejes së qarkullimit, për mjete në pronësi dhe ato më qira.

Sipas shtojcës 12, Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, Pjesa II, Pika A-Deklarata për përmbushjen e kriteve të përgjithshme të kualifikimit, është përcaktuar që referencat për këto

lloj deklaratash do të bëhen në rastet kur janë të zbatueshme: “Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni”. Pra, Komisioni gjykon, se ka dy mënyra se si autoriteti kontraktor mund t’i marrë këto dokumente, e para në bazë të të dhënave të aksesueshme shtetërore nëse është i disponueshëm dhe e dyta **Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të VKM-së, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.** Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor në fazën e vlerësimit procedural në të cilin ndodhet aktualisht procedura e prokurimit objekt-ankimi, për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, duhet t’i referohet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas rubrikave të aksesueshme elektronikisht nga autoriteti kontraktor dhe kërkesës për **dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të VKM-së, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.** Akoma më tej, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është me vend të theksojë rolin e posaçëm që ka autoriteti kontraktor, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti/enti kontraktor ai që duhet t’i kërkojë **ofertuesit të kualifikuar, i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të VKM-së 285.** Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin, për t’u siguruar nëse cilësia e shërbimit, punës apo mallit është e njëjtë me cilësinë e premtuar në momentin apo fazën e ofertimit. Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm për këtë fazë. KPP gjykon, se arsyeja e skualifikimit për operatorin ekonomik në rastin konkret, nuk është në përputhje me kriterin e kualifikimit të vendosur nga autoriteti kontraktor për plotësimin e këtij kapaciteti. Për më tepër, KPP vëren, se legjislacioni i prokurimit publik i njeh të drejtën autoritetit kontraktor, por dhe vetë ky i fundit ka rezervuar në dokumentet standarde të tenderit edhe të drejtën e verifikimit apo sqarimit nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, lidhur me vërtetësinë dhe saktësinë e informacionit që përmbajnë dokumentet e paraqitura nga ata, dhe më pas të marrë vendim lidhur me to.

Në këto kushte, Komisioni gjykon, se skualifikimi i operatorit ekonomik ankimues nga ana e autoritetit kontraktor nuk është i drejtë.

Për sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Rruga Ura Asfaltim Nr.2 Elbasan” SHPK qëndron.

III.7. Lidhur me pretendimet e BOE “Biba-X” SHPK & “Bimak” SHPK, për sa i përket vendimit të KVO-së për kualifikimin e shoqërisë “A.L Asfalt” SHPK në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se interesi i tij i ligjshëm, i drejtpërdrejtë e real (*përkundrejt atij imagjinar*), nuk ka sesi të dëmtohet nga suksesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi të cilët kanë ofertuar me një vlerë

më të lartë ekonomike, ndaj dhe këto pretendime nuk do të merren në shqyrtim nga ky Komision.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e BOE “Biba-X” SHPK & “Bimak” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr.REF-94268-01-31-2024, me objekt: “Blerje Asfalti” me fond limit 37.500.000 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 19.02.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kavajë.
2. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Ruga Ura Asfaltim Nr.2 Elbasan” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.
3. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshme të procedurës së prokurimit.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga BOE “Biba-X” SHPK & “Bimak” SHPK.
5. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Ruga Ura Asfaltim Nr.2 Elbasan” SHPK.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaid Myzyri

